SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Lloji i diplomës "Shkenca Bujqesore" niveli minimal i diplomës "Bachelor"

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, Bashkia Kuçovë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionet:

- 1 (një) Specialist Mjedisi, kategoria IV-2.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!
Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës se pranimit në shërbimin civil.

Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil)

aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e Dokumenteve për Lëvizjen Paralele: 25.10.2026

Afati për dorëzimin e Dokumenteve për Pranim në Shërbimin Civil : 30.10.2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Te realizoj zbatimin e ligjeve per mbrojtjen e mjedisit.
- Siguron kontrollin lokal te mbrojtjes se mjedisit sipas legjislacionit ne fuqi
- Kryen kontrolle për hetimin e zonave te ndotura ose potencialisht te ndotura.
- Per te zgjidhur ndikimet negative ne mjedis dhe problemet e shumta me komunitetin ,bashkerendon punen dhe kerkon nderhyrjen e policis bashkiake bazuar ne ligjin nr.139 dt.17.12.2015 “Per vetqeverisjen vendore” .
- Zbaton planet dhe projektet e zhvillimit, është përgjegjës kryesor për identifikimin dhe menaxhimin e problemeve mjedisore dhe ujore brenda territorit te bashkisë.
- Zbaton me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprorët e tij ne lidhje me fushën e Mjedisit.
- Sipas njesise teritoriale qe ka nen juridiksion ,ushtron kontroll per gjendjen e perbersve te veçante te mjedisit.
- Evidenton probleme që dalin nga veprimtaria e përditshme si dhe shqetësimet e ndryshme që ngrihen nga qytetarët, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe i propozon drejtorit rrugëzgjidhjet përkatëse..
- Zbaton nismat mjedisore
- Si pjese e rendesishme e rrjetit institucional mjedisor ushtron kontroll ndaj veprimtarive te zoteruesve te mbetjeve urbane ne zbatimin e rregullave dhe te kerkesave per krijimin , grumbullimin ,ruajtjen,transportimin ,perpunimin dhe asgjesimin e mbetjeve urbane,te mbetjeve te ndertimit dhe te mbetjeve te vellimshme.
- Merr pjese ne monitorimin e treguesve mjedisore sipas ligjit 162 dt.04.12.2014,”Per mbrojtjen e cilesise se ajrit te mjedisit”
- Mbane te dhenat statistikore per:
  -Per hedhurinat e ngurta urbane

  -sasite vjetore te prodhimit

  -shperndarjen e mbetjeve sipas teritorit

  - Per shkarkime te lengeta urbane

  - Mbetjet spitalore

  -sasia vjetore e shkaktuar dhe shperndarje sipas njesive teritoriale

  -Per shkarkimet e ngurta industriale dhe inerte

  -vellimi i mbeturinave inerte te sektorit te ndertimit dhe shperndarja e tyre sipas njesive teritoriale .

- Realizon kontrollin paraprak dhe merr ne dorezim dokumentacionin perberes per çdo kerkese qe paraqitet ne protokoll ne adrese te Inspektorit te mjedisit.
- Raporton periodikisht te eprori direkt per punen e realizuar dhe problemet qe ndeshen .

- Inspekton dhe disiplinon transportin dhe ndertimet ne mjediset qytetese ne bashkepunim me Drejtorine e Sherbimeve , Inspektoriatin e Ndertimit dhe Urbanistiken.
- Merr masa ne bashkepunim me ARM-ne per paisjen e subjekteve private apo shteterore qe ndikojne ne mjedis me leje apo autorizime mjedisore .
- Ne bashkepunim me strukturat perkatese merr masa per monitorimin e cilesise se ajrit urban,ndotjes akustike si dhe cilesise se ujrave urbane .

I - Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi ;
- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit ,“Bachelor” në “ Shkenca Bujqesore”, (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
c) Të ketë njohuri në programet kompjuterike,
d) Preferohet të zotërojnë njohuri të gjuhën angleze.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkise Kuçove ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente
b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h- Vërtetim nga Institucioni qe nuk ka masë displinore në fuqi.
i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 25.10.2026

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 27.10.2026, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkise Kuçove ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*.
c) Njohuritë mbi Ligjin *nr. 10431 "Per mbrojtjen e Mjedisit"* i ndryshuar.
d) Njohuritë mbi Ligjin nr. 10448 date 14.07.2011 "*Per Lejet e mjedisit*" i ndryshuar.
e) Njohuritë mbi vendimin Nr. 103, datë 31.3.2002 *"Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise"*.
f) Njohuri Mbi Ligjin Nr.9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" I ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, "*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*", të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Kuçove do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2 - Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nepunesit civil", i ndryshuar.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

e) Të jetë shtetas shqiptar;
f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
g) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
h) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
i) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
j) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit ,"Bachelor" në " Shkenca Bujqesore", (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
c) Te kete njohuri ne programet kompjuterike,
d) Preferohet të zotërojnë njohuri të gjuhën angleze.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente
b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë displinore në fuqi;
i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 30.10.2026, në Bashkine Kucove.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj proçedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **09.11.2026**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkise Kucove, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*.
c) Njohuritë mbi Ligjin *nr. 10431 "Per mbrojtjen e Mjedisit"* i ndryshuar.
d) Njohuritë mbi Ligjin nr. 10448 date 14.07.2011 "*Per Lejet e mjedisit*" i ndryshuar.
e) Njohuritë mbi vendimin Nr. 103, datë 31.3.2002 *"Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise"*.
f) Njohuri Mbi Ligjin Nr.9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" I ndryshuar.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
b- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;

c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al

http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Kuçovës do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

KRYETARI I BASHKISË

Kreshnik HAJDARI